


Implikimet Ekonomike dhe Sociale të COVID-19: **Kosova dhe Ballkani Perëndimor**

Qershor 2020



Implikimet Ekonomike dhe Sociale Të COVID-19: **Kosova dhe Ballkani** **Perëndimor**

Qershor 2020

Financuar nga:

Ky publikim është i financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) dhe përgatitur nga Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest.

Deklaratë mohimi:

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të mbështetësve.

Autor:

Pëllumb Çollaku

Design:

Envinion

Origjinali është shkruar në shqip.

Publikuar nga:

RIINVEST INSTITUTE

Lidhja e Prizrenit nr. 42

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

tel: + 381 (0)38 244320 | 38 223816

e-mail: riinvest@riinvestinstitute.org

www.riinvestinstitute.org

E drejta autoriale © 2020 nga INSTITUTI RIINVEST.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të reproduktohet, të ruhet në ndonjë sistem reproduktimi, apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik, apo mekanik, fotokopjues, regjistrues apo tjetër, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky dokument është hartuar në kuadër të projektit 'Përmirësimi i politikave për të përballuar efektet negative të virusit COVID-19' (Corona Virus Disease, 2019) të financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), dhe mbulan temën e parë të projektit "Implikimet ekonomike dhe sociale të COVID-19: Kosova dhe Ballkanit Perëndimor". Dokumenti synon përmirësimin e politikave për të përballuar efektet negative të situatës ekonomike që COVID-19 ka krijuar në shtetet e Ballkanit Perëndimor (BP), përfshirë njësitë vetëdijen mbi nevojën e qasjes me frytdhënëse e me prioritetë përfshirë evitimin e pasojave të mëtutjeshme ekonomike, dhe përmirësimin e informacionit tek institucionet, mediat, opioni dhe akterët tjerë të interesuar.

Situata akute me përhapjen e COVID-19 si në rrafshin global ashtu edhe në Ballkanin Perëndimor (BP) jo vetëm që po kanos me rrezikim serioz të gjendjes shëndetësore dhe viktimat që po merr si dëm kapital, por po përcillet edhe me pasoja në reduktimin drastik të aktiviteteve ekonomike dhe përkohësimin e situatës sociale në rajon. Qeveritë e Ballkanit Perëndimor (BP), duke ditur fragilitetin e sistemeve të tyre shëndetësore, po ndjekin shembullin e vendeve të prekura më pare, por në shkallë dukshëm më kufizuese se vendet fqinje të Bashkimit Evropian (BE). Shtetet e Ballkanit Perëndimor (BP) futën në funksion masa të repta kufizuese si distancimi fizik dhe orare të kufizuarë lëvizjesh e orë policore si preventive përfshirë përballur me valën e pandemisë. Përderisa dëmet kapitale në njerëz mbeten një mister dhe do të dihen saktësisht vetëm në të ardhmen, dëmi ekonomik është veçse prezent në të gjitha ekonomitë përfshiri dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor (BP), shtetet e të cilat si dhe shumica e shteteve tjera, përveç kufizimeve të ndërveprimit social e fizik suspendoi edhe shumë aktivitete ekonomike.

Përderisa debati në shoqëri lidhur me pasojet ekonomike e sociale të COVID-19 është intensifikuar, nuk duket sa duhet i bazuar në hulumtime të paanshme duke qenë i ngarkuar nga këndvëshrimet e veçanta sektoriale ose interesave parciiale. Andaj, ky briefing mbi politikat (policy brief) është një vështrim mbi efektin e masave të shëndetit publik që vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor (BP) kanë ndërmarrë përfshirë parandalimin e pandemisë. Gjithashtu, briefingu evidenton kanalet kryesore ekonomike përmes

të cilëve pritet që ekonomia të goditet më së shumti, duke ofruar rekandime përfshirë amortizim sa më të madh të dëmit ekonomik në shtetet e Ballkanit Perëndimor (BP).

Nëpërmjet hulumtimit të raporteve dhe analizës së të dhënavë sekondare ky dokument do të shtojë vlerë në debatin ekzistues rrëth efekteve ekonomike të COVID-19 në shtetet e Ballkanit Perëndimor (BP), duke kontribuar që të kuptohet dimioni real në planin shëndetësor dhe ekonomik. Në bazë të hulumtimit nxjerrim rekandimet e nevojshme përfshirë situatën aktuale, në mënyrë që të amortizohet dhe minimizohet dëmi aktual dhe i ardhshëm ekonomik i Kosovës. Ky briefing do të prezantohet në opinion publik dhe tek institucionet qeveritare, në Kuvend, tek komuniteti i biznesit dhe aktorët tjerë të interesuar.

Përfundimet kryesore nga ky raport hulumtues janë:

- Të mbahet numri i infektiveve i vogël sepse Kosova dhe shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor (BP) kanë sisteme shëndetësore fragjile dhe numër të limituar të personelit shëndetësor.
- Deficitet fiskale të shteteve të BP do të zgjerohen konsiderueshëm si rezultat i shpenzimeve të mëdha e të nevojshme në shëndetësi, në përkrahje të bizneseve dhe të papunëve, dhe recessionit të pashmangshëm ekonomik. Në këtë situatë, qeveritë e duhet të orientohen drejt institacioneve relevante financiare, kryesisht Fondit Monetar Ndërkombëtar, përmeshtetje financiare dhe këshillime përfshirë konsolidime fiskale.
- Kanalet e vërteta makroekonomike të ndikimit të COVID-19 në shtetet e rajonit është vështirë të maten në përgjithësi, por tri më kryesoret janë tregtia ndërkombëtare, turizmi, dhe neto bilanci në energji.
- Të gjitha parashikimet janë që ndikimi i pandemisë COVID-19 në punësim dhe paga do të jetë më i madh sesa pasojet e shkaktuara nga kriza financiare globale e vitit 2008.

1. HYRJE

Përhapja e pandemisë COVID-19 si rezultat i infektimit me virusin Corona gjatë muajve të parë të vitit 2020 në të gjithë botën ka krijuar një shok të madh ekonomik duke zbehur parashikimet e ekonomike për ekonominë globale, e me të edhe të ekonomive të BE-së, dhe gjithashtu rajonit të Ballkanit Perëndimor (BP) ku bën pjesë edhe Kosova. Tanimë stuhia ekonomike që vie si pasojë e masave të ndërmarra për të ulur trendin e infektimeve është mbi ne.

Përderisa dëmet kapitale në njerëz mbeten një mister i së ardhmes, dëmi ekonomik është veçse prezent në të gjitha ekonomitë në botë duke përfshirë dhe Ballkanin Perëndimor (BP) bashkë me Kosovën, e cila, si vendet tjera, përveç kufizimeve të ndërveprimit social e fizik suspendoi edhe shume aktivitete ekonomike përveç atyre më thelbësoreve.

Për këtë, është e nevojshme të analizojmë te dhënat në dispozicion dhe informatat tjera relevante që të mund të kuptojmë dëmin e vërtetë ekonomik. Megjithëse kohëzgjatja e masave shtrënguese është e panjohur, meqë nuk dihet edhe vetë kohëzgjatja e pandemisë dhe gjendjes emergjente, është mëse e domosdoshme, e nevojshme dhe urgjente që sa më parë të hedhim dritë mbi trendet aktuale dhe masat e ndërmarra nga ana e qeverive në Ballkanin Perëndimor (BP), dhe në bazë të tyre të nxjerrim rekomandimet e nevojshme për situatën aktuale në mënyrë që të amortizohet dhe minimizohet dëmi aktual dhe i ardhshëm ekonomik i rajonit.

Dëmi ekonomik nuk po vie vetëm nga sëmundja, por edhe nga masat shtrënguese që qeveritë në rajon janë detyruar të marrin hap pas hapi që të ndalin shpërndarjen e sëmundjes. Kështu, shtetet një pas një, përfshi Kosovën, kanë marrë masa drakonike si ndalimi i të qëndruarit fizikisht afér njëri-tjetrit dhe ndalimi i bashkëveprimit shoqëror. Ne do të hedhim dritë mbi trendet e rezultateve të këtyre masave në aspektin e jetës së njerëzve.

Këto masa nënkuptojnë që kurbat ekonomike pothuajse janë rrënuar, dhe kjo na lë të kuptojë që sipas paramasave fillestare bota do të jetë dëshmitare, në versionin më të mirë të një rrënimisë ekonomik së paku aq të madh sa ai i krizës financiare globale të vitit 2008, dhe me shumë gjasë shumë më të madh dhe më të thellë se ky. Në këtë drejtim,

neve do mundohemi të pasqyrojmë gjendjen aktuale të rajonit, për aq sa të dhënat na lejojnë që të shqyrtojmë pozicionin e secilit shtet në indikatorët relevantë në të cilët pritet që kriza e COVID-19 më së shumti të reflektohet.

Duke patur në mendje që kjo krizë është e ndryshme nga ajo globale financiare e vitit 2008, dhe unike në brendësinë e saj pasi që dëmon të dy anët e ekonemisë, ofertën dhe kërkesën, do të jetë e nevojshme të shqyrtohet nga të dy thjerrëzat/perspektivat analitike, shëndetësore dhe ekonomike, duke sjellë në shqyrtim problematikat më urgjente të shteteve të rajonit.

2. PANDEMIA COVID-19 DHE BALLKANI PERËNDIMOR

Shtetet e Ballkanit Perëndimor (BP) vetëm së fundi kanë arritur të rikuperohen nga efektet shpërndarëse të krizës së eurozonës duke regjistruar rritje të fortë ekonomike vitet e fundit. Pjesërisht kjo i është atribuar ardhjeve të reja të investimeve të huaja direkte, posaçërisht në Serbi dhe Maqedoni Veriore, në sektorë si industritë përpunuese, duke krijuar mijëra vende të reja të punës. Pandemia COVID-19 ka ndërprerë këndelljen ekonomike të rajonit ku parashihet një recession i pashmangshëm i rajonit për vitin 2020 me shifra që sillen me një rënje të Bruto Produktit Vendor (BPV) mes 3.5-5% (Banka Botërore, 2020; Fondi Monetar Ndërkombëtar - IMF, 2020; Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik - OECD, 2020). Edhe pse politikat e deritashme vendore kanë qenë relativisht të suksesshme, ato vështirë se mund të ndalin ekonomitë e rajonit drejt rënies ekonomike duke marrë parasysh se të gjitha janë të lidhura ngushtë me fatkeqësinë ekonomike të BE-së dhe recessionin i cili duket i pashmangshëm, e posaçërisht në Itali, në të cilin vend ndikimi i krizës në ekonomi ka qenë më i rëndë, dhe në vendet tjera të prekura më së shumti, e me të cilat rajoni është i lidhur ngusht ekonomikisht.

Ndikimi i pandemisë COVID-19 në nivel global dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor (BP) është i përcaktuar nga dy faktorë: i) nga kapaciteti i sistemeve shëndetësore të bashkëveprojnë, dhe ii) nga gjendja aktuale e financave publike të këtyre vendeve, rrjedhimisht, aftësisë që të mbështesin ekonominë përgjatë rënies - punëtorët dhe bizneset.

Për të dy faktorët, perspektiva e Ballkanit Perëndimor (BP) nuk duket shumë premtuese. Edhe nëse përshtatet me kostot lokale, shpenzimet publike në sistem shëndetësor për kokë banori në rajon janë mesatarisht 15% i nivelit të Gjermanisë, dhe vetëm 1/3 e nivelit të vendeve të pasura të Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL) sikurse Sllovenia ("Eastern Europe Coronavirus tracker," n.d.)(Instituti i Vjenës pë Studime të Ekonomisë Ndërkombëtare - WIIW, 2020). Duke u nisur nga këto premisa, edhepse rastet e infektuara nuk rritheshin aq shpejt sa në vendet tjera, qeveritë e Ballkanit Perëndimor (BP) ndërmorën shpejt masa të cilat

Pandemia COVID-19 ka ndërprerë këndelljen ekonomike të rajonit ku parashihet një recession i pashmangshëm i rajonit për vitin 2020 me shifra që sillen me një rënje të Bruto Produktit Vendor (BPV) mes 3.5-5% (Banka Botërore, 2020; Fondi Monetar Ndërkombëtar - IMF, 2020; Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik - OECD, 2020).

kufizuan rëndë jetën ekonomike, më shumë sesa në pjesë tjetra të rajonit të Europës Qendrore dhe Lindore (EQL) dhe asaj Juglindore.

Hapësira për manovrim fiskal duket e limituar. Nëse krahasohen premisat e para-krizës financiare globale me ato të para-pandemisë COVID-19, vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) kanë hyrë në krizën e fundit me një shkallë më të lartë të borxhit publik në raport me BPV-në (mesatarja rjonale është 22 pikë përqindje më e lartë në 2020 sesa ajo në vitin 2007 ("Eastern Europe Coronavirus tracker," n.d.)(WIIW, 2020). Për më tepër, bankat qendrore në rajon nuk do të janë në gjendje të ngrisin borxhin qeveritar në të njëjtin nivel si ekonomitë e zhvilluara si pasojë e kësaj situate. Një gjë e tillë po reflektohet edhe në planet stimuluese fiskale pothuajse në të gjitha qeveritë e rajonit të cilat po tregohen më të ndruajtura krahasuar me shtetet e EQL.

në mungesë të auto-pjesëve kritike që prodhohen në Kinë, të nevojshme për procesin prodhues të pjesëve të prodhua nga fabrika e automjeteve në Kragujevc ("Fiat closes European plant as coronavirus hits supply chain," n.d.).

4. Rënie e konsiderueshme pritet gjithashtu në të ardhurat nga turizmi, veçanërisht në Mal të Zi dhe Shqipëri, në të cilat vende turizmi dhe udhëtimi përbëjnë rreth 1/5-tën e ekonomisë, duke dëmtuar kështu ofertën vendore për së paku disa muaj.

Pasojet ekonomike të COVID-19

1. Të gjitha parashikimet janë që ndikimi i pandemisë COVID-19 në punësim dhe paga do të jetë më i madh sesa pasojet e shkaktuara nga kriza financiare globale e vitit 2008.
2. Rënia në remitenca, e shprehur në hyrje të remitencave zyrtare, pritet si pasojë e shokut në tregun e punës në vendet e zhvilluara, e sidomos në sektorët në të cilët kryesisht emigrantët janë të punësuar. Kjo rënie mendohet se do të përkeqësojë pasojet e pas pandemisë COVID-19 pasi që ndikimi i saj është i konsiderueshëm. Sa për ilustrim, pa llogaritur kontributin e turizmit të diasporës (mjetet që emigrantët kosovarë shpenzojnë personalisht kur vijnë në Kosovë), sipas Bankës Botërore, remitencat llogariten të përbëjnë rreth 10 përqind të BPV-së në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Shqipëri, dhe mbi 15 përqind në Kosovë (Banka Botërore, 2020).
3. Rënia në të hyrat nga eksporti është e pritshme pasi që kërkesa përmallra dhe shërbime nga BE prej vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP) është e mundshme të zgjedhë. Kjo mund të ndodhë poashtu edhe si rezultat i ndërprerjes së funksionimit të zinxhirit prodhues të vlerës nëse kompanitë multinacionale me lokacion në regjion mbyllin aktivitetet e tyre siç është rasti me kompaninë e prodhimit të automjeteve Fiat në Serbi e cila mbylli operimet e veta në Shkurt 2020

3. PASQYRA SHËNDETËSORE E BALLKANIT PERËNDIMOR DHE COVID-19

Në mënyrë që të përballen me efektet e pandemisë COVID-19, të gjitha vendet e rajonit të BP, përfshin Kosovën, kanë vendosur të implementojnë pothuajse të njëjtën politikë, atë të sheshimit të lakores në mënyrë që të ngadalësojnë përhapjen e COVID-19. Sheshimi i lakores nënkuption që do ketë më pak raste në secilën pikë të lakores në çfarëdokohe, dhe është më shumë një strategji për të ngadalësuar përhapjen e sëmundjes por jo të eliminojë gjasat e marrjes së sëmundjes. Rrjedhimisht, nuk është e quartë nëse do kemi më pak raste në përgjithësi, por jep kohë në zhvillimin e vaksinës, parandalon mbingarkimin e sistemit të kujdesit shëndetësor duke ulur numrin e

vdekjeve (mosngarkesa i mundëson qendrave mjekësore që t'u ofrojë më me komoditet shërbime pacientëve të prekur për pajisje në mungesë si ventilator, respiratorë, etj.). Sheshimi i lakores poashtu shtyen kulmin e krizës duke e bërë procesin e përhapjes së sëmundjes më të gjatë duke i rritur gjasat që deri në një kohë të gjëjmë mundësi më të mira të trajtimit të COVID-19.

Shtetet e BP, duke ditur fragilitetin e sistemit të tyre shëndetësor kanë reaguar me shpejtësi në vendosjen e masave drakonike në kufizimin e lëvizjes, distancës sociale dhe aktiviteteve ekonomike.

TABELA 1: Indikatorët mjekësorë rrreth pandemisë COVID-19 në shtetet e Ballkanit Perëndimor (BP), dhe popullsia.

Shteti	Raste aktive COVID-19	Nr. i vdekjeve nga COVID-19	Nr. i testimeve për COVID-19	Nr. i popullsisë
BeH	564	146	59,934	3,282,698
Kosova	217	30	13,505	1,845,000
Mali i Zi	0	9	10,167	628,058
Maqedonia V.	447	113	25,528	2,083,382
Serbia	5,034	239	220,344	6,982,600
Shqipëria	193	33	13,506	2,878,095
Cjithsej	6,455	570	342,984	19,457,884


BURIMI: TË DHËNAT PËR RASTET COVID-19 JANË NGA INSTITUTET KOMBËTARE TË SHËNDETËSISË PUBLIKE TË VENDEVE PËRKATËSE, DERI MË 25 MAJ, 2020; TË DHËNAT E POPULLSISË NGA BANKA BOTËRORE, EUROSTAT DHE ZYRET KOMBËTARE TË STATISTIKAVE.

Nëse bëhet krahasim me vendet tjera të BE si Italia, Spanja, etj, të cilat vende kanë qenë të prekura rëndë nga pandemia, BP duket që ka kaluar lehtë pikun e përhapjes së virusit. Tabela 1 më poshtë ilustron situatën aktuale dhe të deritanishme nëlidhje me rastet active, të vdekjeve, testimeve, dhe numrin e popullsisë për secilin nga shtetet e rajonit.

Deri më 25 Maj, 2020, nga të cilat informata është ndërtuar tabela e mësipërme, Kosova renditet në vendin e tretë në

rajon për nga numri i rasteve active me COVID-19 derisa Mali i Zi duket se ka tejkaluar me sukses krizën në shëndetin publik. Serbia ka numrin më të madh të rasteve, por të njëjtën kohë edhe popullsinë më të madhe. Një pasyrë më të quartë rrëth këtij proporcioni jep Figura 1 e cila si një vlerë krahasuese jep edhe mesataren e numrit të të infektuarve në raport me popullsinë.

FIGURA 1: Numri i infektimeve në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë në vendet e Ballkanit Perëndimor, i shprehur në përqindje, periudha 13 Mars – 25 Maj, 2020.



BURIMI: INSTITUTET KOMBËTARE TË SHËNDETËSISË PUBLIKE, 2020. KALKULIMET E AUTORIT

Nëse të njëjtat të dhëna i përpunojmë për të nxjerrë koeficientë relevantë për të kuptuar rezultatin e masave të ndërmarrë mund të shpalosim më shumë informacion

sikurse në Tabelën 2 më poshtë. Në të shihet qartë që Serbia qëndron më së keq i rajon me një koeficient prej 0.2% të popullsisë me raste aktive me COVID-19.

TABELA 2. Indikatorë krahasimorë të trendit të pandemisë COVID-19 në Ballkanin Perëndimor (BP), në përqindje.

Shteti	Numri i testimeve/Nr. i popullsisë	Rastet aktive/Nr. e popullsisë	Nr. i vdekjeve/nr. i infektive	Nr. i infektive/Nr. i testimeve
BeH	1.83%	0.02%	6.07%	4.01%
Kosova	0.73%	0.01%	2.89%	7.69%
Mali i Zi	1.62%	0.00%	2.78%	3.19%
Maqedonia V.	1.23%	0.02%	5.65%	7.83%
Serbia	2.52%	0.06%	2.14%	5.08%
Shqipëria	0.47%	0.01%	3.21%	7.62%

BURIMI: TË DHËNAT PËR RASTET COVID-19 JANË NGA INSTITUTET KOMBËTARE TË SHËNDETËSISË PUBLIKE TË VENDEVE PËRKATËSE, DERI MË 25 MAJ, 2020; TË DHËNAT E POPULLSISË NGA BANKA BOTËRORE, EUROSTAT DHE ZYRET KOMBËTARE TË STATISTIKAVE. KALKULIMET E AUTORIT.

Gjithashtu zbulojmë që Serbia ka bërë edhe numrin më të madh të testimeve të popullsisë ku 2.52% e ppullsisë janë testuar, me Shqipërinë e cila renditet e fundit me numrin më të vogël të qytetarëve të testuar për COVID-19 (0.47%), ku Kosova qëndron e parafundit (0.73%).

Numrin më të madh të vdekjeve nga gjithsejt infektimet rezulton ta ketë BeH (6.07%), e ndjekur nga Maqedonia e Veriut me 5.65%. Shkallën më të ultë të vdekjeve në rajon e mbani Serbia me 2.14%, ndërsa Kosova ka një përqindje prej 2.89% të të infektuarve përfundojnë me vdekje.

Në raste si ky, gjendja e sistemit shëndetësor dhe aftësia e tij që të përballojë një krizë të shëndetit publik është kryesorja. Në fakt, dobësimi i sistemit shëndetësor dhe eksodi masiv i stafit mjekësor nga shtetet e BP drejt BE-së zbehnin mundësitë e një suksesi të shpejtë. Zaten kjo

mbbase është dhe arsyёja kryesore pse shtetet e rajonit vendosën të aplikojnë, për dallim nga vendet tjera më të pasura, një model me stimulim fiskal të ulët kombinuar me dsitancë shoqërore të ashpër. Meqë kualiteti i sistemit shëndetësor të një vendi varet nga pasuria, atëherë s'do mend që shtetet më të pasura të janë më të suksesshme në tejkalimin më të shpejtë të situatës.

TABELA 3. Indikatorë të shëndetit publik në shtetet e Ballkanit Perëndimor (BP), në përqindje.

Viti	Popullata mbi 65 vjeç, % e totalit	Shpenzimet qeveritare në shëndetësi, % e BPV	Shpenzimet qeveritare në shëndetësi, US\$ per capita
	2020 (est)	2017	2017
BeH	17.9	9.2	443.8
Kosova	6.3	2.5	104.8
Mali i Zi	15.8	7.6	531.7
Maqedonia V.	14.5	6.3	327.8
Serbia	19.1	9.1	494.4
Shqipëria	14.7	6.7	271.5

BURIMI: TË DHËNAT PËR POPULLSINË MBI 65 VJEÇ JANË VLERËSIMË PËR VITIN 2020 NGA BANKA BOTËRORE DHE EUROSTAT, PËR KOSOVËN NGA AGJEN-CIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS, PËR VITIN 2018; TË DHËNAT MBI SHPENZIMET QEVERTARE NË SHËNDETËSI NGA OBSH, BANKA BOTËRORE, WIWI DHE INSTITUTI GAP. KALKULIMET PËR KOSOVËN JANË BËRË NGA AUTORI.

Në rajon renditet më së miri BeH e cila shpenzon 9.2% të BPV-së në shëndetësi në vitin 2017 (shih Tabelën 3). Kosova në këtë indikator renditet e fundit në rajon me vetëm 2.5% të BPV-së së shpenzuar në shëndetësi.

Fatmirësisht, meqë COVID-19 atakon më shumë të moshuarit, tek e cila grupmoshë shkalla e vdekjeve është më e lartë – rasti me Italinë, shtetet e rajonit me popullsi më të re pritet të dalin më pak të dëmtuara në jetë njerëzish, ku Kosova qëndron në një situatë shumë të favorshme karshi shteteve tjera të rajonit, me vetëm 6.3% të popullatës mbi 65 vjeç kundrejt Serbisë e cila renditet ‘më e moshuara e rajonit’ me 19.1%. Ndërsa, në shpenzimet në shëndetësi për kokë banori më së larti qëndron Mali i Zi me 531.7 USD

(2017) ndërsa e fundit vie Kosova me shumë dukshëm më të vogël prej 104.8 USD (2018).

Më 1 Qershor 2020, u kalua ne fazën III të heqjes së masave shtrënguese që nënkupton aktivizimin e sektorit të akomodimit - hotelet, restoranet, kafenetë, dhe çerdhet, dhe hapjen e kufijve tokësor. Edhepse e mirëseardhur për ekonominë, ende nuk kemi të dhëna të rritjes së kapaciteteve të institucioneve shëndetësore për testime, përcjellje dhe krijim të bazës së të dhënave për kontaktet dhe mbikëqyrjen e tyre rigorozë. Kjo është shumë me rëndësi pasi një ‘liberalzim’ i tillë mund të sjell rritjen e numrit të rasteve dhe për pasojë rrezikun e kthimit të trendeve në kahjen e padëshirueshme.

4. PASQYRA EKONOMIKE E BALLKANIT PERËNDIMOR DHE COVID-19

4.1 Situata fiskale në Ballkanin Perëndimor dhe COVID-19

Deficitet fiskale të shteteve të rajonit të Ballkanit Perëndimor (BP) do të zgjerohen konsiderueshëm si rezultat i shpenzimeve të mëdha e të nevojshme në shëndetësi, në përkrahje të bizneseve dhe të papunëve, dhe recessionit të pashmangshëm ekonomik. Në këtë situatë, qeveritë e katër shteteve duhet të orientohen drejt institucioneve relevante financiare, kryesisht Fondit Monetar Ndërkombëtar, për mbështetje financiare. Në këtë përpjekje do të jetë më vështirë të sigurohen mjete nga tregjet ndërkombëtare të kapitalit pasi që edhe atop o përjetojnë lëkundje të njëpasnjëshme, dhe investitorët e

huaj nuk kanë të njëjtin përceptim mbi rajonin siç e kishte para pandemisë. Shtetet në rajon nuk janë të ngarkuara shumë me borxh, ku Kosova ka posaçërisht një pozitë të lakmueshme. Përjashtim bëjnë Mali i Zi dhe Shqipëria që mund të hasin në pengesa të financimit nga jashtë pasi që borxhet e tyre publike në relacion me BPV-në shënojnë vlera dukshëm më të larta (shih Tabelën 4). Gjatë kohës së krizës pritet që shtetet ti rrisin llogaritë e tyre të borxheve të cilat do të mbesin të larta për një kohë, borxh për të cilin një pjesë të barrës do ta bartin gjeneratat e ardhshme.

TABELA 4. Hapësira fiskale dhe mundësia për reagim

	Bilanci buxhetor, % e BPV	Borxhi publik, % e BPV
BeH	1,0	31,7
Kosova	0,7	17,2
Mali i Zi	-2,3	69,0
Maqedonia V.	-2,1	48,8
Serbia	0,7	52,0
Shqipëria	-1,9	67,5

BURIMI: WIIW, 2019.

4.2 Faktorët makroekonomik dhe COVID-19 në Ballkanin Perëndimor

Kanalet e vërteta makroekonomike që do të ndikohen gjatë kësaj krize duket e vështirë të maten në përgjithësi. Sidoqoftë, në këtë publikim të shkurtë ne po renditim tri më kryesoret: hapjen tregtare, varësinë nga turizmi, dhe neto bilancin në energji. Ballkani Perëndimor (BP) karakterizohet me ekonomi të vogla dhe të hapura, dhe kryesisht të varura nga tregtia. Andaj, gjëja e parë që shkon ndër mend është fakti që ato do të goditen rëndë nga rënia dhe çrregullimi në tregtinë botërore. Edhe pse, kjo mund të jetë e vërtetë, prapëserapë ajo mund të jetë përcaktuese vetëm në një të ardhme afatmesme, pasi që problem kryesor është rënia e kërkësës vendore nëpër shtete si rezultat i kufizimit të jetës normale ekonomike. Megjithatë, me stimulimin e madh fiskal që Gjermania dhe ekonomitë e zhvilluara pritet t’l ofrojnë ekonomisë së tyre, vendet e lidhura me të pritet të përfitojnë nga këto masa në formë të efekteve pozitive shpërndarëse duke rritur eksportet, remitencat, etj.

Sektori i turizmit është dërmuar nga kriza e shkaktuar nga COVID-19. Nëse situata vazhdon me kufizime të lëvizjes si intra- dhe ndër-shtetërore, gjë që ende nuk është asgjë e sigurt për hapje, horizonti nuk jep shpresë pozitive për ekonomitë e varura shumë nga turizmi, si rasti i Malit të Zi dhe Shqipërisë. Si sektor në rritje në gjithë regionin, pritet të ketë efekte të përhapura në tërë rajonin. Për Kosovën situata është posaçërisht delikate, pasi që pjesa dërmuese e asaj që llogaritet turizëm, është turizëm i diasporës – emigrantëve që kthehen në vendlindje gjatë pushimeve, e që sipas disa paralogarive llogaritet rrëth 400 milionë euro (5.7% e BPV-së), që nuk raportohet nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, e cila raporton vetëm grupimin ‘Hotele dhe restorane’. Nëse kufizimet për udhëtimet ndër-shtetërore nuk hiqen, atëherë Kosova pritet të goditet rëndë nga masa të tillë. Për detaje mbi varësinë e ekonomisë nga turizmi shih më poshtë Tabelën 5.

TABELA 5: Indikatorët kryesor makroekonomik, në përqindje.

Shtetet	Hapja tregtare, % e BPV (2019)	Turizmi*, % e BPV (2016)	Neto bilanci i energjisë, % e BPV (2019)
BeH	99,2	9,9	-5,0
Kosova	82,0	1,2	-6,4
Mali i Zi	109,6	25,1	-4,1
Maqedonia V.	133,8	6,8	-6,4
Serbia	110,1	6,7	-4,8
Shqipëria	77,1	26,3	-1,4

BURIMI: BANKA BOTËRORE DHE WIIW.

NOTE: * KALKULIMET PËR TURIZMIN NË KOSOVË JANË BËRË NGA TË DHËNAT E DISPONUESHME NË AGJENCINË E STATISTIKAVE TË KOSOVËS, VETËM PËR KATEGORINË ‘HOTELE DHE RESTORANE’, VITI 2018; KALKULIMET E AUTORIT.

Tabela 5 tregon poashtu që të gjitha shtetet e BP janë importues të energjisë. Meqë eksperiencia na mëson se humbjet në eksportuesve jo medoemos përkthehen në

fitime të importuesve, çmimet e energjisë nuk do thotë që do bien, andaj, pjesëmarrja e madhe e importit të energjisë në BPV mund ta përkeqësojë gjendjen.

5. RIMËKËMBJA EKONOMIKE E BP DHE COVID-19

Rimëkëmbja ekonomike e vendeve të BP pas masave restrikтиве të qeverive si për qytetarët e poashtu edhe për bizneset varet nga shumë faktorë, si shkalla e ardhshme e përhapjes së virusit, kujdesi i qytetarëve në respektimin e udhëzimeve për shëndetin publik, sistemeve shëndetësore, etj. Duke patur parasysh këta faktorë, konsiderojmë që trajektorja e rimëkëmbjes mund të kalojë në dy skenarë kryesorë, varësisht edhe nga aftësia e shteteve për mbështetje financiare të akterëve ekonomik.

Në skenarin e parë jemi dëshmitarë të një situate kujeta ekonomike ka qenë e kufizuar ashpër për 3 muaj. Në këtë opçion, ne supozojmë që izolime parçiale përgjatë rajonit mund të ndodhin edhe pas lehtësimit të kufizimeve, varësisht nga trendi i infektiveve, derisa të kemi një vaksinë brenda 12-18 muajve të ardhshëm.

Në këto kushte, rënia e BPV-së në terma real, që sipas parashikimeve të ndryshme në rajon sillet të jetë rreth 3-5 përqind, na jep indikacion që punësimi dhe pagat në rajon në 2020 do të kenë një rënie më të madhe sesa ajo e krizës financiare të vitit 2008. Edhe viti pasues pritet të jetë i vështirë, me një kendellje të lehtë të pritshme në pjesën e dytë të vitit të ardhshëm (2021) derisa kushtet e përgjithshme ekonomike dhe sociale pritet të përmirësohen në mënyrë thelbesore në 2022.

Një skenar i dytë më pozitiv për një rimëkëmbje më të shpejtë do të përfshinte tri gjëra: i) një stimulim fiskal të koordinuar në zonën e euros me efekte shpërndarëse materiale edhe për Ballkanin Perëndimor (BP); ii) vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP) t'u alokohen ndihma të jashtme financiare (pa masa shtrënguese nga ndihmëdhënësit), duke lënë hapësirë edhe për disa masa stimuluese ekonomike të limituara; dhe iii) testimi masiv të niset shpejtë në rajon duke lejuar një kthim më të shpejtë në një shkallë më të lartë të jetës normale ekonomike. Në këtë skenar, sipas WIIW, pritet një tkurrje më e vogël e BPV-së në shkallë reale në 2020, me një rimëkëmbje të denjë në 2021.

Në një skenar të tretë, më negativ, të analizuar nga (BiEPAG, 2020), një rënie e thollë e aktivitetit ekonomik në rajon do të shkaktojë situatën e dështimit të shumë bizneseve. Mbyllja e bizneseve e shoqëruar me papunësi do të shpjere në mospagesë të borgjeve në institucione financiare duke kthyer një krizë shëndetësore në një krizë financiare. Ky skenar jo vetëm që nëkupton një rënie të thollë ekonomike në 2020 (me një rënie potenciale të BPV-së reale në mes 5-10 përqind, dhe vështirësi të mëdha për popullatën), por edhe një ndikim afatgjatë negativ në ekonomi si ai i krizës së vitit 2008, me papunësi të lartë, paga të ulta dhe rritje të papërfillshme ekonomike për disa vite.

6. INTERVENIMET E REKOMANDUARA

Të mbahet numri i infektimeve i vogël. Kjo është e një rëndësie të veçantë pasi që vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) kanë sisteme shëndetësore fragjile dhe numër të limituar të personelit shëndetësor.

Të intensifikohet bashkëpunimi dhe koordinimi rajonal si preventivë për tensione të reja dhe lehtësim për të koordinuar masat e vendeve midis tyre dhe hapjen graduale të ekonomive. Në anën tjetër BE duhet të intensifikojë prezencën në rajon duke futur në pakot e saj të rimëkëmbjes ekonomike post-COVID-19 edhe vendet e Ballkanit Perëndimor (BP).

Qeveritë duhet të ofrojnë mbështetje financiare për NVM-të. Ka nevojë të dizajnohen politika të favorshme që nxisin ndërmarrjet e mëdha të mobilizojnë resurset e tyre dhe të fusin në funksion rezervat e keshit, nëse kanë. Skema serioze të garancive kreditore nga qeveria duhet të vihen ne funksion më fuqishëm, të tillë që ofrojnë mbështetje serioze në kreditim. Turizmi, transporti, shërbimet dhe agrikultura duhet të kenë përkrahje më të shtuar e sidomos bizneset mikro dhe NVM-të, ë cilat janë goditur më së rendi nga kriza e pandemisë.

Qeveritë duhet të angazhohen më thelbësishët dhe në mënyrë më dinamike në dizajnimin, koordinimin dhe organizimin e politikave për promovimin e zinxhirit të vlerës në industritë ushqimore; trajtim dhe shërbim i veçantë për furnizime ushqimore dhe dërgesa duhet t'u bëhet kategorive të varfra dhe të moshuarve.

Masa përkrahëse për eventualisht emigrantët e kthyer, si rezultat i humbjes së vendeve të tyre të punës në vendet ku kanë emigruar, si dhe të atyre që kthehen në vendet e tyre pas periudhës së të qenit të bllokuar shkaku i pandemisë në vendet tjera nga vendi i tyre i origjinës.

Përfshirja e të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP) në mekanizmat e asistencës së BE-së që kanë të bëjnë me ndikimin ekonomik të pandemisë COVID-19 duhet të jetë e vazhdueshme shkaku i hapësirës fragjile fiskale që kanë shumica e vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor (BP).

REFERENCAT

- The Balkans in Europe Policy Advisory Group (BiEPAG) (2020). Western Balkans in Times of Global Pandemic. April 2020. Graz, Austria.
- Eastern Europe Coronavirus tracker: Preparing for the worst (news article) [WWW Document], n.d. . wiiw.ac.at. URL <https://wiiw.ac.at/n-430.html> (accessed 6.1.20).
- International Monetary Fund (2020). IMF Country Report No. 20/112, Republic of Kosovo. April, 2020. Washington D.C., USA.
- Organisation for Economic Cooperation and Development (2020). COVID-19 Crisis Response in South East European Economies. April 2020. Paris, France.
- Eastern Europe Coronavirus tracker: Preparing for the worst (news article) [WWW Document], n.d. . wiiw.ac.at. URL <https://wiiw.ac.at/n-430.html> (accessed 6.1.20).
- Fiat closes European plant as coronavirus hits supply chain [WWW Document], n.d. . Supply Management. URL <https://www.cips.org/supply-management/news/2020/february/fiat-closes-european-plant-as-coronavirus-hits-supply-chain/> (accessed 6.1.20).

